

RAPORT MUJOR I FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT “ALBSIG”

QERSHOR 2025

Emërtimi i Fondit: Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur, Smart Pension (“Fondi”)

Shoqëria Administruese: Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Albsig Invest sh.a.

Monedha Bazë: Lekë

Politika e Investimit: Fondi ka një tolerancë të ulët rreziku (konservator) duke respektuar parimin e sigurisë, diversifikimit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm për investimet afatgjata. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi (obligacione) afatgjatë të emetuar ose të garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Objektivi i investimit është rritja e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe horizonti i investimit është afatgjatë.

PROFILI I RREZIKUT DHE PËRFITIMIT

RREZIK I ULËT

Përfitime zakonisht të ulëta

RREZIK I LARTË

Përfitime zakonisht të larta

1	2	3	4	5	6	7

Fondi bie në kategorinë e parë të profilit të rrezikut, e cila është kategoria me rrezikut më të ulët. Kategoria e rrezikut përbën një rrezik sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator rreziku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator rreziku më të ulët.

Të dhënat kryesore për Fondin më 30.06.2025

Vlera Neto e Aktiveve :	830.892.689,75 ALL
Çmimi për kuotë:	1.178,9071
*Kthimi nga Investimit (30 Qershor 2024-30 Qershor 2025):	4.21%


**Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.*

KOSTOT DHE TARIFAT

- Komisioni vjetor i administrimit do jetë 2.5% në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit.

SHPËRNDARJA E AKTIVEVE

Kategoria e Aktiveve	Vlera (në lekë)	% ndaj Aktiveve
Tituj të emtuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.	820,544,988.11	98.75%
Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë.	10,347,701.64	1.25%

ECURIA E ÇMIMIT PËR KUOTË DHE PERFORMANCA E FONDIT.


Kthimi vjetorë neto rezulton 4.21% për periudhën 30 Qershor 2024-30 Qershor 2025.

Më poshtë shfaqen kthimet vjetore të Fondit për periudhat 2 vjeçare, 3 vjeçare, dhe 5 vjeçare deri më 30 Qershor 2025. Performanca e kaluar nuk duhet të përdoret si udhëzues për performancën në të ardhmen. Fondi ka filluar aktivitetin në **07.02.2020**.

Albsig	5Y	3Y	2Y	1Y
Norma Vjetore e Kthimit	3.23%	3.88%	4.15%	4.21%